**DEKRET**
**Nr.134, datë 22.2.1992**

**PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7521,DATË 30.11.1991 PËR PËRKRAHJEN SOCIALE PËR PERSONAT QË TË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE**

Në mbështetje të nënit 28, të ligjit 7491, datë 29.4.1991,"Për dispozitat kryesore kushtetuese",me propozim të Këshillit të Ministrave.

DEKRETOJ

Neni 1

Në ligjin nr.7521,datë 30.10.1991,Në nenin 2 shtohen shkronjat"d","e" dhe "f" me këtë përmbajtje:

d) Ushtarët e liruar nga ushtria në vitin 1991 e këtej ,që mbeten pa pune e që para kryerjes së shërbimit ushtarak kanë qene të punësuar,me banim në qytete,qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore

e) Specialistët e mesëm të bujqësisë që punonin në kooperativat bujqësore dhe që kanë dalë të papunë nga zvogëlimi,riorganizimi e prishja e kooperativave bujqësore, me banim në qytete,qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore

f) sh të Dënuarit dhe të dëbuarit politike me banim në qytete,qendra të banuara,ndërmarrje bujqesore,si dhe ata me banim në fshatra,familjet e te cilëve nuk kanë toke,që kanë qënë të punësuar në vëndet e internimit dhe pas lirimit janë të papunë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëhërë.

PRESIDET I REPUBLIKËS
**Ramiz Alia**